

L I G J
Nr. 7935, datë 18.5.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7720, DATË 14.6.1993 “PËR KONTROLLIN DHE
DISIPLINIMIN E NDËRTIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7720, datë 14.06.1993, neni 6 ndryshohet si vijon:

“Zbatimi i punimeve kryhet nga ndërmarrjet shtetërore ose nga personat fizikë a juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencat përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore. Drejtuesi i punimeve i emëruar nga investitori, duhet të jetë person juridik ose fizik, që plotëson kushtet sipas dispozitave në fuqi. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e drejtuesit të punimeve caktohet një punonjës i investitorit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1108, datë 30.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha